



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRRREGULLATORE PËR UJËSJELLËS DHE KANALIZIM
REGULATORNI URED ZA VODU I KANALIZACIJU
WATER AND WASTEWATER REGULATORY OFFICE



RAPORT VJETOR VLERËSIMI

MBI PËRMBUSHJEN E CAQEVE TË PËRCAKTUARA

ME PROCESIN TARIFOR 2012-2014

ANALIZË VLERËSIMI PËR VITIN 2012

Prishtinë, Maj 2013

Vizioni

“Shërbime cilësore, të sigurta dhe efëiente të ujit për të gjithë konsumatorët në Kosovë.”

Misioni

“Rregullimi efektiv, transparent i shërbimeve të ujit dhe kanalizimit, në pajtim me praktikat e mira Evropiane, të cilat sigurojnë shërbime kuantitative dhe kualitative, të qëndrueshme me çmime të përballueshme në tërë Kosovën, duke pasur parasysh ruajtjen e mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit publik.”

PËRMBAJTA

1	Hyrje	5
2	Sfidimi i biznes planeve rregullatore	6
3	Aplikimi i inflacionit	7
4	Metodologjia e vlerësimit të caqeve	8
4.	Analiza e prodhimit, faturimit dhe konsumatorët	9
4.1	Paraqitja grafike e ujit të prodhuar, ujit të humbur, ujit të faturuar në m ³ dhe numrit të konsumatorëve.....	10
5.	Analiza e shpenzimeve operative	12
5. 1	Shpenzimet operative për ujë dhe ujëra të zeza	13
5.2	Paraqitja grafike e shpenzimeve operative për ujë dhe ujëra të zeza	14
6.	SHUMAT E FaturimiT dhe arkëtimi në vlerë monetare	16
6.1.	Shuma e faturimit për shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza.....	17
6.2	Paraqitja grafike e faturimit për ujë dhe ujëra të zeza	18
6.3.	Shuma e arkëtimit për shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza	19
6.4.	Paraqitja grafike e arkëtimit për ujë dhe ujëra të zeza	20
7.	Investimet kapitale	21
7.1.	Shumat e Investimeve kapitale nga financimet vetanake.....	22
7.2.	Paraqitja grafike e të dhënave për investime kapitale vetanake të kompanive	25
7.3.	Shumat e investimeve kapitale të financuara nga donatorët	26
7.4.	Paraqitja grafike e të dhënave për investimet kapitale nga donatorët	29
7.5.	Investimet në përtëritjen e infrastrukturës.....	30
8.	Përshtatja e tarifave për vitin 2013	32

Akronimet dhe shkurtesat

BPRR	Biznes Plane Rregullatore
FE	Kompania Rajonale e Ujit Bifurkacioni (Ferizaj)
GJA	Kompania Rajonale e Ujit Radoniqi (Gjakova)
GJI	Kompania Rajonale e Ujit Hidromorava (Gjilan)
KRU	Kompania Rajonale e Ujit
MIT	Kompania Rajonale e Ujit Mitrovica (Mitrovicë)
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
NjPMNP	Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike
PE	Kompania Rajonale e Ujit Hidrodrini (Pejë)
PR	Kompania Rajonale e Ujit Prishtina (Prishtinë)
PZ	Kompania Rajonale e Ujit Hidroregjioni Jugor (Prizren)
ZRRUK	Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
IÇKK	Indeksi i Çmimit të Konsumit në Kosovë
BRRA	Baza Rregullatore e Aseteve

1 HYRJE

Ky raport pasqyron të dhënat e performancës së shtatë (7) kompanive regjionale të shërbimeve të ujit dhe ujërave të zeza, me të cilën vlerësohet përmbushja e caqeve të përcaktuara me procesin rregullatorë të tarifave 2012-2014 për vitin 2012 dhe jep një pasqyrë të përgjithshme të sektorit për periudhën e shikuar.

Raporti është përgatit mbi bazën e disa të dhënave kryesore operative dhe financiare të përcaktuara si cak për vitin 2012 të akorduara mes kompanive dhe ZRRUK-ut dhe të dhënave të realizuara të kompanive gjatë vitit të shikuar, si dhe të dhënave krahasuese historike të viteve 2012/2011.

Qëllimi i këtij raporti është i trefishtë:

- (i) Të jepet informacion për trendin e treguesve operativ dhe financiar të KRU-ve dhe në veçanti për shkallën e investimeve kapitale të realizuara për periudhën e shikuar kohore.
- (ii) Të krahasohen treguesit e punës së KRU-ve me objektivat (caqet) e përcaktuara të procesit tariforë të periudhës së shikuar dhe në rast të shmangieve të mëdha në këtë plan të mundësohet kompanive të ndërmarrin veprime me kohë për të ndryshuar, ose korrigjuar trendët e tilla jo të favorshme.
- (iii) Të vlerësohen efektet e tarifave të reja të aplikuara nga fillimi i vitit të shikuar gjer në fund të periudhës të vitit 2012 dhe viteve pasuese 2013 dhe 2014 etj.

Shënim;

Të dhënat e KRU "Mitrovica" sh. a. Mitrovicë, pasqyrohen për gjithë regjionin me të gjitha shërbimet që i ofron kjo kompani duke i përfshi edhe shërbimet e furnizimit me ujë të trajtuar me shumicë të pjesës Veriore të Qytetit të Mitrovicës.

2 SFIDIMI I BIZNES PLANEVE RREGULLATORE

Edhe pse në raportin përmbyllës tarifar 2012-2014 është përshkruar në detaje mënyra se si ZRRUK ka sfiduar Biznes Planet Rregullatore (BPRR) të kompanive gjatë procesit të përcaktimit të tarifave, kemi konsideruar të arsyeshme që edhe në këtë raport të bëjmë një përshkrim të shkurtër se si ZRRUK ka kërkuar nga KRU-të të jenë më eficientë në shërbimet e tyre ndaj konsumatorëve.

Parimi bazë i procesit rregullatorë ka qenë qëndrueshmëria financiare për kompanitë që nënkupton shërbime më të mira për konsumatorët e shërbyer, të cilat shpresojmë se do të arrihen me tarifa të arsyeshme të cilat janë të përballueshme për të gjitha kategoritë e konsumatorëve të shërbyer, sikurse që kemi përcaktuar edhe caqe sfiduese për përmirësim të performancës së përgjithshme të tyre, dhe atë:

1. ZRRUK mendon se shpenzimet operative janë shumë më të larta se sa ato do të duhej të ishin, dhe roli i tyre ngritët pasi që kanë ndikim të drejtpërdrejt në tarifa. Gjatë diskutimeve tona me disa nga përfaqësuesit e kompanive kemi kërkuar nga ta që kostot e tyre të larta t'i përafrojnë me kostot mesatare të sektorit.
2. Ne besojmë se KRU-të kanë një shkallë të lartë të humbjeve komerciale, shumë kyçje të pa ligjshme dhe faturim jo të kënaqshëm, të cilat duhet të jenë fokus të menaxhmenteve për t'i minimizuar ato, ose sjellë në relacione optimale .
3. Edhe pse performanca në arkëtimin e të ardhurave është duke u përmirësuar, vendosmërisht jemi të mendimit se përmirësimet janë shumë të ulëta në krahasim me atë se sa ato do duhej të ishin, edhe pse ne kemi qenë të kujdesshëm për të mos qenë shumë ambicioz tek këta tregues themelorë për procesin rregullatorë 2012-2014.

Prandaj, ZRRUK do të;

- kryejë monitorim të rregullt për të vlerësuar shkallën e përmbushjes së objektivave të përcaktuara me procesin aktual rregullator (siç po bëjmë edhe me këtë raport) ,
- mos përmbushja e caqeve të përcaktuara për vitin 2012 do të ketë si pasojë veprimet legjitime të ZRRUK-ut për të rishikuar tarifat e vitit 2013 sikurse që do të veprohet edhe për vitin 2014 , të raportojë gjetjet tek aksionari në cilësinë e pronarit të kompanive dhe te palët tjera të interesit.

3 APLIKIMI I INFLACIONIT

Përderisa qëllimi i këtij raporti kryesisht ka të bëjë me vlerësimin e shkallës së përmbushjes së caqeve të përcaktuara me procesin tarifar 2012-2014, për vitin 2012, për të qenë ky raport dhe vlerësimi në të sa ma real , të dhënat financiare të aprovuara nga ZRRUK për vitin 2012 të paraqitura në tabelat e mëposhtme janë të përshtatura me Indeksin e Çmimeve të Konsumit në Kosovë publikuara nga Agjencioni i Statistikave të Kosovës për periudhe e caktuar kohore.

Duhet theksuar se, të dhënat financiare të aprovuara për vitin 2012 kanë marrë për bazë çmimet e mesit të vitit 2011 (Qershor 2011 = 121.4), ngase edhe BPRR për procesin tarifar 2012-2014 janë dorëzuara gjatë asaj kohe.

Për këtë, të dhënat financiare të aprovuara nga ZRRUK për vitin 2012 në tabelat e mëposhtme, ndryshojnë prej të dhënave financiare që gjenden në BPRR, tek secila KRU. Të dhënat financiare të aprovuara për vitin 2012, në këtë raport, kanë marrë për bazë të dhënat e BPRR-ës duke i shumëzuar me IÇKK 1.02814. Ky indeks është fituar duke pjesëtar mesataren e IÇKK për vitin 2012 (124.817) me IÇKK-ën e mesit të vitit 2011 (121.4).

Sikurse edhe u theksuar ma lartë qëllimi i këtij raporti ka të bëjë me vlerësimin e shkallës së përmbushjes së caqeve të përcaktuara me procesin tarifar 2012-2014 për vitin 2012, ZRRUK ka konsideruar të arsyeshme që të dhënat financiare historike për vitin 2011 të mos indeksohen me IÇK, ngase një krahasim i tillë edhe ashtu nuk do të ndikonte në vendimet e ZRRUK rreth tarifave të ardhshme.

4 METODOLOGJIA E VLERËSIMIT TË CAQEVE

Metodologjia e vlerësimit të përmbushjes së caqeve të përcaktuara me procesin tarifar 2012-2014 për vitin 2012, do të jetë uniforme për të gjitha kategoritë e të dhënave të realizuara nga KRU-të për periudhën e shikuar kohore.

Kjo metodologji do të pasqyrohet në tabela përkatëse për të gjitha kategoritë e të dhënave, sikurse në vijim:

- të dhënat historike të realizuara nga KRU për vitin 2011,
- të dhënat e aprovuara nga ZRRUK për vitin 2012,
- të dhënat e realizuara nga KRU për vitin 2012,
- përqindja krahasuese e vitit 2012 me atë të vitit 2011,
- përqindja e realizimit të caktuar për vitin 2012, dhe
- vlerësimi përfundimtar.

Përqindja krahasuese e vitit 2012 me atë të vitit 2011 është raporti i të dhënave të dala nga treguesit e arritur të viteve të shikuara dhe të shumëzuar me 100.

Përqindja e realizimit të caktuar për vitin 2012 del si rezultat i raportit të dhënave të aprovuar nga ZRRUK me të dhënat e realizuara të kompanive dhe sektorit për vitin e shikuar dhe të shumëzuar me 100.

Vlerësimi përfundimtar për vitin 2012 i paraqitur në kolonën e fundit është vlerësim i rregullatorit, duke i identifikuar si:

Shkurtesa	Përshkrimi	Vlerësimi
R	E realizuar	Pozitiv
Jo e R	Jo e realizuar	Negativ
T P	Tejkaluar pozitivisht	Pozitiv
T N	Tejkaluar negativisht	Negativ
E pa K	E pa krahasueshme	Pa të dhëna krahasuese

4. ANALIZA E PRODHIMIT, FATURIMIT DHE KONSUMATORËT


Analiza në vazhdim ofron të dhëna për këto kategori operative të shërbimeve të ujit të shprehura në metër kub (m³): (I) uji i prodhuar, (II) uji i humbur apo i pa faturuar, (III) uji i faturuar, (iv) dhe numrin e konsumatorëve.

Tabela Nr. 1. Pasqyra e të dhënave sasiore për ujin e prodhuar, ujin e humbur, ujin e faturuar, numrin e konsumatorëve, krahasimi e të dhënave 2012/2011 dhe % e përmbushjes së caqeve 2012 me vlerësim


Emri i Kompanisë	Të dhënat operative	Njësia	Historike 2011	Aprovuara 2012	Realizuara nga KRU-të 2012	% krahasuese 2012/2011	% e real. të caktut 2012	Vlerësimi përfundimtar 2012
Prishtina (PR)	Uji i prodhuar	m ³	46,058,090	48,145,228	45,054,046	97.82%	93.58%	Jo e R
	Uji i humbur	m ³	25,238,974	24,115,710	24,094,986	95.47%	99.91%	R
	Uji i faturuar	m ³	20,819,116	24,029,518	20,959,060	100.67%	87.22%	Jo e R
	Konsumatorët	Nr	87,671	100,703	94,917	108.26%	94.25%	Jo e R
Hidroregjioni Jugor (PZ)	Uji i prodhuar	m ³	20,439,596	20,838,579	19,673,736	96.25%	94.41%	Jo e R
	Uji i humbur	m ³	12,917,706	12,986,678	11,998,622	92.89%	92.39%	R
	Uji i faturuar	m ³	7,521,890	7,851,901	7,675,114	102.04%	97.75%	Jo e R
	Konsumatorët	Nr	33,490	33,137	36,226	108.17%	109.32%	T P
Hidrodrini (PE)	Uji i prodhuar	m ³	27,713,863	28,539,150	26,981,112	97.36%	94.54%	Jo e R
	Uji i humbur	m ³	19,420,065	19,548,404	17,908,203	92.21%	91.61%	R
	Uji i faturuar	m ³	8,293,798	8,990,746	9,072,909	109.39%	100.91%	T P
	Konsumatorët	Nr	34,522	32,123	32,534	94.24%	101.28%	T P
Mitrovica (MIT)	Uji i prodhuar	m ³	17,770,938	17,960,000	17,610,092	99.09%	98.05%	Jo e R
	Uji i humbur	m ³	9,287,101	8,354,162	9,117,685	98.18%	109.14%	Jo e R
	Uji i faturuar	m ³	8,483,837	9,605,838	8,492,407	100.10%	88.41%	Jo e R
	Uji i faturuar -J	m ³	4,642,360	5,405,838	4,507,452	97.09%	83.38%	Jo e R
	Uji i faturuar-V	m ³	3,841,477	4,200,000	3,984,955	103.73%	94.88%	Jo e R
	Konsumatorët	Nr	21,794	23,061	22,815	104.68%	98.93%	Jo e R
Radoniqi (GJA)	Uji i prodhuar	m ³	20,377,470	20,519,867	15,073,168	73.97%	73.46%	Jo e R
	Uji i humbur	m ³	14,260,865	14,078,131	8,877,219	62.25%	63.06%	R
	Uji i faturuar	m ³	6,116,605	6,441,736	6,195,949	101.30%	96.18%	Jo e R
	Konsumatorët	Nr	27,345	28,750	28,703	104.97%	99.84%	Jo e R
Bifurkacioni (FE)	Uji i prodhuar	m ³	6,905,947	6,441,229	6,109,204	88.46%	94.85%	Jo e R
	Uji i humbur	m ³	4,520,488	3,108,660	3,572,431	79.03%	114.92%	Jo e R
	Uji i faturuar	m ³	2,385,459	3,332,569	2,536,773	106.34%	76.12%	Jo e R
	Konsumatorët	Nr	16,976	17,593	15,905	93.69%	90.41%	Jo e R
Hidromorava (GJI)	Uji i prodhuar	m ³	7,181,811	7,454,529	7,610,126	105.96%	102.09%	T P
	Uji i humbur	m ³	4,251,703	4,082,610	4,640,044	109.13%	113.65%	Jo e R
	Uji i faturuar	m ³	2,930,108	3,371,919	2,970,082	101.36%	88.08%	Jo e R
	Konsumatorët	Nr	19,085	18,911	20,106	105.35%	106.32%	T P
SEKTORI	Uji i prodhuar	m ³	146,447,71	149,898,58	138,111,48	94.31%	92.14%	Jo e R
	Uji i humbur	m ³	89,896,902	86,274,355	80,209,190	89.22%	92.97%	R
	Uji i faturuar	m ³	56,550,813	63,624,227	57,902,294	102.39%	91.01%	Jo e R
	Konsumatorët	Nr	240,883	254,278	251,206	104.29%	98.79%	Jo e R

4.1 Paraqitja grafike e ujit të prodhuar, ujit të humbur, ujit të faturuar në m³ dhe numrit të konsumatorëve


Të dhënat e tabelës Nr. 1. janë paraqitur grafikisht përmes grafikoneve të cilat mundësojnë krahasimin më të lehtë vizual të të dhënave historike 2011, të dhënave aprovuara nga ZRRUK dhe të dhënave të realizuara nga KRU-të gjatë vitit 2012.




Uji i faturuar në m3



Konsumatorët



Përqindja e realizimit të të dhënave operative



5. ANALIZA E SHPENZIMEVE OPERATIVE

Sikurse u cek edhe më lartë, gjatë procesit tarifar 2012-2014, ZRRUK ka kërkuar nga KRU-të të jenë më të kujdesshëm me shpenzimet e tyre të drejtpërdrejta operative dhe ka kërkuar që të njëjtat të ulen deri në optimumin e arsyeshëm.

Për të qenë më konsekuent në aprovimin e shpenzimeve operative të cilat kanë ndikim direkt në lartësinë e tarifës, ne kemi përdorur metodën e regresionit të uljes së shpenzimeve të tilla për ato kompani që kanë pas shpenzime operative mbi shpenzimet optimale mesatare të disa kompanive të vlerësuara si shpenzime të arsyeshme dhe për këtë arsye kemi konsideruar se kjo është metoda më e arsyeshme dhe më transparente për reduktimin e tyre të KRU-të të cilat konsiderohen me shpenzime jo shumë racionale.

Të dhënat e shpenzimeve operative të paraqitura në këtë raport janë kategorizuar konform udhëzimeve të kontabilitetit rregullator, fillimisht duke i ndarë shpenzimet operative për ujë dhe kanalizim.

Sipas UKRR, shpenzimet operative për ujë i kemi paraqitur të ndara në tri kategori:

- shpenzimet operative në resurse dhe trajtim
- shpenzimet operative në distribuim, dhe
- shpenzimet operative në aktivitete biznesore

Ndërkaq, shpenzimet operative për ujëra të zeza, janë të ndara në 4 kategori, dhe atë:

- shpenzimet operative në grumbullimin e ujërave të zeza
- shpenzimet operative në trajtimin e ujërave të zeza
- shpenzimet operative në trajtimin e llumit
- shpenzimet operative në aktivitete biznesore

Për detaje më të hollësishme se cilat zëra të shpenzimeve operative futen në kategoritë përkatëse, mund të konsultoheni me Udhëzimet e Kontabilitetit Rregullator, i cili gjendet i publikuar në ueb faqen zyrtare të ZRRUK (www.wwro-ks.org).


5.1 Shpenzimet operative për ujë dhe ujëra të zeza

Në këtë tabelë janë të paraqitura shpenzimet operative për ujë dhe ujëra të zeza për secilën KRU dhe sektor, duke paraqitur shpenzimet operative historike të vitit 2011, ato të aprovuara nga ZRRUK si dhe ato të realizuara nga KRU-t gjatë vitit 2012, shkallën e përmbushjes së caqeve në % dhe vlerësimi përfundimtarë për këtë periudhë kohore.





Tabela Nr. 2 Pasqyra e të dhënave të shpenzimeve operative për ujë dhe ujëra të zeza në €


Emri i Kompanisë	Zërat e shpenzimeve operative	Njësia	Historike 2011	Aprovuar nga ZRRUK 2012	Realizuara nga KRU 2012	% krahasuese 2012/2011	% e real. të caktut 2012	Vlerësimi përfundimtar 2012
Prishtina (PR)	Ujë	€	7,430,855	5,523,971	7,805,924	105.05%	141.31%	T N
	Ujëra të Zeza	€	230,036	203,466	248,855	108.18%	122.31%	T N
	Totali	€	7,660,891	5,727,437	8,054,779	105.14%	140.63%	T N
Hidroregjioni jugor (PZ)	Ujë	€	2,310,684	2,346,193	2,634,194	114.00%	112.28%	T N
	Ujëra të Zeza	€	117,403	128,965	135,687	115.57%	105.21%	T N
	Totali	€	2,428,087	2,475,158	2,769,882	114.08%	111.91%	T N
Hidrodrini (PE)	Ujë	€	1,495,704	1,583,565	1,545,594	103.34%	97.60%	R
	Ujëra të Zeza	€	80,108	86,163	88,679	110.70%	102.92%	T N
	Totali	€	1,575,812	1,669,728	1,634,273	103.71%	97.88%	R
Mitrovica (MIT)	Ujë- Jugu	€	1,263,396	1,012,175	1,233,720	97.65%	121.89%	T N
	Ujë- Veriu	€	472,501	672,000	637,593	134.94%	94.88%	R
	Ujëra të Zeza	€	116,011	167,205	197,772	170.48%	118.28%	T N
	Totali	€	1,851,908	1,851,380	2,069,085	111.73%	111.76%	T N
Radoniqi (GJA)	Ujë	€	1,723,500	1,587,699	1,963,927	113.95%	123.70%	T N
	Ujëra të Zeza	€	160,752	82,562	143,474	89.25%	173.78%	T N
	Totali	€	1,884,252	1,670,260	2,107,401	111.84%	126.17%	T N
Bifurkacioni (FE)	Ujë	€	654,556	740,397	731,433	111.74%	98.79%	R
	Ujëra të Zeza	€	61,231	54,826	56,237	91.84%	102.57%	T N
	Totali	€	715,787	795,223	787,670	110.04%	99.05%	R
Hidromorava (GJI)	Ujë	€	1,015,865	919,250	1,111,096	109.37%	120.87%	T N
	Ujëra të Zeza	€	97,548	77,863	109,468	112.22%	140.59%	T N
	Totali	€	1,113,413	997,113	1,220,564	109.62%	122.41%	T N
Të dhënat sektoriale	Ujë	€	16,367,06	14,385,25	17,663,481	107.92%	122.79%	T N
	Ujëra të Zeza	€	863,089	801,050	980,173	113.57%	122.36%	T N
Totali i përgjithshëm sektorial		€	17,230,15	15,186,30	18,643,654	108.20%	122.77%	T N

Nga totali i shpenzimeve operative që kanë ndodhur gjatë vitit 2012, 94.74% të shpenzimeve kanë ndodhur në shërbimin e ujit, ndërsa 5.26% janë shpenzime të ujërave të zeza. Totali i shumës së shpenzimeve operative të realizuara për të dy shërbimet nga KRU-të gjatë vitit 2012 ka qenë 18,643,654 €, të cilat si të tilla janë tejkaluar nga shuma e aprovuar nga ZRRUK për vitin 2012 në lartësi prej 22.77%.



5.2 Paraqitja grafike e shpenzimeve operative për ujë dhe ujëra të zeza





Prej grafikonit të mësipërm, vërehet qartë se vetëm dy kompani, dhe atë vetëm KRU: “Hidrodrini” sh. a. Pejë dhe “Bifurkacioni” sh. a. Ferizaj, kanë arritur që t’i kenë nën kontroll shpenzimet e tyre operative, kurse të gjitha KRU-të tjera kanë shpenzuar më tepër para se sa u është aprovuar me procesin tarifor 2012-2014, për vitin 2012.

6. SHUMAT E FATURIMIT DHE ARKËTIMI NË VLERË MONETARE

Të dhënat për faturim dhe arkëtim në vlerë monetare do të paraqiten po ashtu në formë tabelore, për krahasim me të lehtë të rezultateve të arritura nga kompanitë dhe sektori gjatë vitit 2012 me ato të aprovuara nga ZRRUK për të njëjtën periudhë kohore, sipas procesit rregullator të përcaktimit të tarifave të viteve 2012-2014.

Edhe këto të dhëna do të paraqiten sipas shërbimeve të ofruara; veç për shërbimet e ujit dhe veç për shërbimet e kanalizimit dhe pastaj të përmbledhura do të paraqiten për çdo kompani veç e veç dhe për sektorin si tërësi përgjatë periudhës së shikuar të vitit 2012 dhe për krahasime do të pasqyrohen edhe të dhënat e tilla të realizuara të vitit 2012 me të dhënat historike për vitin 2011.

Konform politikave tarifore, të cilat janë publikuar nga ZRRUK në Mars të vitit 2011, faturimi dhe arkëtimi nga tarifa fikse dhe volumetike i atribuohet shërbimeve të ujësjellësit, ndërsa tarifa volumetrike për kanalizim i atribuohet si e vetme shërbimeve të ujërave të zeza.

Duke pasur parasysh se jo të gjitha KRU-të kanë qenë në gjendje të bëjnë ndarjen e arkëtimin për ujë dhe ato për ujëra të zeza, ZRRUK ka qenë i detyruar që të bëjë këtë ndarje sipas një gjykimi të cilin ne e kemi konsideruar si më të arsyeshmin, për kushtet në të cilat gjendemi. Kjo ndarje është bazuar në faturimin e planifikuar sipas BPRR të aprovuar nga ZRRUK dhe ato të realizuara nga KRU-të dhe sektori të cilit i takojnë.

Shënim:

Duhet theksuar se për KRU "Mitrovica" sh. a. Mitrovicë, Qeveria e Republikës së Kosovës ndan mjete nga Buxheti i Republikës së Kosovës çdo vit, që nga pas lufta, për të mbuluar një shumë të caktuar të shpenzimeve operative të cilat krijohen me rastin e furnizimit me ujë të pjesës Veriore të Qytetit të Mitrovicës. Në mënyrë që vlerësimi i ZRRUK të jetë real, këto shuma, nuk do të futen në tabelën e arkëtimin në euro, për të vlerësuar përmbushjen e këtij caku të vitit 2012.


6.1. Shuma e faturimit për shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza

Në këtë tabelë është paraqitur faturimi i shërbimeve të ujit dhe ujërave të zeza në vlerë monetare, për të dhënat historike të vitit 2011, ato të aprovuara nga ZRRUK dhe të realizuara nga KRU-të dhe sektori gjatë vitit 2012.




Tabela Nr. 3 Pasqyra e të dhënave të faturimit për ujë dhe ujërave të zeza në vlerë monetare

Emri i Kompanisë	Të dhënat e faturimit për:	Nësa	Historike 2011	Aprovuara nga ZRRUK 2012	Realizuara nga KRU 2012	% krahasues e 2012/2011	% e real. të cakt. 2012	Vlerësimi përfundimtar 2012
Prishtina (PR)	Ujë	€	10,567,299	13,171,585	11,433,046	108.19%	86.80%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	864,797	1,290,633	1,089,881	126.03%	84.45%	Jo e R
	Totali	€	11,432,096	14,462,218	12,522,927	109.54%	86.59%	Jo e R
Hidroregjioni jugor (PZ)	Ujë	€	2,983,141	3,685,545	3,369,434	112.95%	91.42%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	315,026	448,774	390,817	124.06%	87.09%	Jo e R
	Totali	€	3,298,167	4,134,319	3,760,251	114.01%	90.95%	Jo e R
Hidrodrini (PE)	Ujë	€	2,467,827	2,937,520	2,700,965	109.45%	91.95%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	241,532	351,327	318,463	131.85%	90.65%	Jo e R
	Totali	€	2,709,359	3,288,847	3,019,428	111.44%	91.81%	Jo e R
Mitrovica (MIT)	Uji total	€	2,286,392	3,198,626	2,641,728	115.54%	82.59%	Jo e R
	Ujë -Jugu	€	1,813,891	2,526,626	2,004,135	110.49%	79.32%	Jo e R
	Ujë - Veriu	€	472,501	672,000	637,593	134.94%	94.88%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	255,147	443,542	344,389	134.98%	77.65%	Jo e R
	Totali	€	2,541,539	3,642,168	2,986,117	117.49%	81.99%	Jo e R
Radoniqi (GJA)	Ujë	€	2,452,362	2,948,647	2,760,849	112.58%	93.63%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	210,254	314,708	302,691	143.96%	96.18%	Jo e R
	Totali	€	2,662,616	3,263,355	3,063,540	115.06%	93.88%	Jo e R
Bifurkacioni (FE)	Ujë	€	969,954	1,450,855	1,140,422	117.57%	78.60%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	161,773	431,267	219,505	135.69%	50.90%	Jo e R
	Totali	€	1,131,727	1,882,122	1,359,927	120.16%	72.25%	Jo e R
Hidromorava (GJI)	Ujë	€	1,225,618	1,579,361	1,345,807	109.81%	85.21%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	189,541	315,345	249,604	131.69%	79.15%	Jo e R
	Totali	€	1,415,159	1,894,706	1,595,411	112.74%	84.20%	Jo e R
Të dhënat sektoriale	Ujë	€	22,952,593	28,972,139	25,392,252	110.63%	87.64%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	2,238,070	3,595,595	2,915,350	130.26%	81.08%	Jo e R
Totali i përgjithshëm sektorial		€	25,190,663	32,567,734	28,307,602	112.37%	86.92%	Jo e R

Është e rëndësishme të theksohet se në sektorin e ujit në Kosovë, 10.30% të shumës së faturimit realizohet nga shërbimi i ujit, ndërsa 89.70% rrjedh nga shërbimi i ujërave të zeza. Në total për sektorin, gjatë vitit 2012 është realizuar faturimi në vlerë prej 28,307,602€, e që paraqet vetëm 86.92% të shumës së aprovuar nga procesi rregullatorë i vitit 2012.



6.2 Paraqitja grafike e faturimit për ujë dhe ujëra të zeza



Nga grafikoni i mësipërm vërehet se asnjëra KRU nuk ka arritur të realizoj faturimin në Euro ashtu siç është aprovuar nga ZRRUK në procesin tarifor 2012-2014, për vitin 2012.


6.3. Shuma e arkëtimit për shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza

Në këtë tabelë është paraqitur arkëtimi për shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza në vlerë monetare, për të dhënat historike të vitit 2011, ato të aprovuara nga ZRRUK dhe të realizuara nga KRU-të gjatë vitit 2012 të cilat si të tilla krahasohen dhe vlerësohen sipas pasqyrës së mëposhtme.




Tabela Nr. 4 Shumat e arkëtimit për shërbimet e ujit në vlerë monetare

Emri i Kompanisë	Faturimi për shërbimet përkatëse	Njësia monetare	Historike 2011	Aprovuara nga ZRRUK 2012	Realizuara nga KRU 2012	% krahasuese 2012/2011	% e real. të caktut 2012	Vlerësimi përfundimtar 2012
Prishtina (PR)	Ujë	€	7,473,467	9,831,464	8,574,751	114.74%	87.22%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	611,607	982,323	816,306	133.47%	83.10%	Jo e R
	Totali	€	8,085,074	10,813,788	9,391,057	116.15%	86.84%	Jo e R
Hidroregjioni jugor (PZ)	Ujë	€	2,155,093	2,682,818	2,414,373	112.03%	89.99%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	227,582	330,178	280,041	123.05%	84.81%	Jo e R
	Totali	€	2,382,675	3,012,996	2,694,414	113.08%	89.43%	Jo e R
Hidrodrini (PE)	Ujë	€	1,522,990	2,112,655	1,536,005	100.85%	72.70%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	149,059	265,410	181,106	121.50%	68.24%	Jo e R
	Totali	€	1,672,049	2,378,065	1,717,111	102.69%	72.21%	Jo e R
Mitrovica (MIT)	Ujë - Jugu	€	1,016,874	1,569,334	995,872	97.93%	63.46%	Jo e R
	Subv. - Veriu		938,474	385,000	694,153	!	!	E pa K
	Ujëra të Zeza	€	143,036	297,886	169,465	118.48%	56.89%	Jo e R
	Totali	€	1,159,910	1,867,219	1,165,337	100.47%	62.41%	Jo e R
Radoniqi (GJA)	Ujë	€	1,749,036	2,239,987	2,147,187	122.76%	95.86%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	149,954	239,889	235,411	156.99%	98.13%	Jo e R
	Totali	€	1,898,990	2,479,876	2,382,598	125.47%	96.08%	Jo e R
Bifurkacioni (FE)	Ujë	€	608,622	985,725	656,602	107.88%	66.61%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	101,509	296,796	126,381	124.50%	42.58%	Jo e R
	Totali	€	710,131	1,282,521	782,983	110.26%	61.05%	Jo e R
Hidromorava (GJI)	Ujë	€	957,142	1,239,292	996,887	104.15%	80.44%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	148,021	249,626	184,890	124.91%	74.07%	Jo e R
	Totali	€	1,105,163	1,488,918	1,181,777	106.93%	79.37%	Jo e R
Të dhënat sektoriale	Ujë	€	15,483,224	20,661,274	17,321,676	111.87%	83.84%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	1,530,768	2,662,109	1,993,600	130.24%	74.89%	Jo e R
Totali i përgjithshëm sektorial		€	17,013,992	23,323,383	19,315,276	113.53%	82.82%	Jo e R

Për sektorin e ujit në Kosovë, sipas vlerësimeve të ZRRUK 89.68% e arkëtimit rrjedh nga shërbimi i ujit, ndërsa pjesa tjetër prej 10.32% rrjedh nga shërbimi i ujërave të zeza. Në total për sektorin, gjatë vitit 2012 është realizuar arkëtimi në vlerë prej 19,315,276 €, e që paraqet vetëm 82.82% të shumës së aprovuar gjatë procesit tarifar për vitin 2012.



6.4. Paraqitja grafike e arkëtimit për ujë dhe ujëra të zeza



Nga grafikoni i mësipërm shihet se asnjëra nga KRU-të nuk ka arritur të realizoj arkëtimin ashtu siç është aprovuar nga ZRRUK në procesin tarifar 2012-2014, për vitin 2012.

7. INVESTIMET KAPITALE

Me aprovimin e tarifave të reja për periudhën afatmesme 2012-2014, ZRRUK ka paraparë që të ndërmerren investime kapitale të konsiderueshme prej të gjitha kompanive të ujësjellësit, këto investime janë të domosdoshme në sistemet e ujësjellësit dhe kanalizimit, të cilat nëse realizohen do të mundësojnë shërbime më cilësore për konsumatorë.

Sipas UKRR-s, investimet kapitale janë klasifikuar si investime në **shërbimet ujësjellësit dhe shërbimet e kanalizimit**, të cilat klasifikohen më tej:

I. Investimet në shërbimet e ujësjellësit më pastaj janë ndarë në:

- Investime në resurse dhe trajtim të ujit,
- Investime në distribuim, dhe
- Investime në aktivitete biznesore.

II. Kurse investimet në shërbimet e ujërave të zeza janë ndarë në:

- Investime në grumbullimin e ujërave të zeza,
- Investime në trajtimin ujërave të zeza,
- Investime në trajtimin dhe derdhjen e llumit, dhe
- Investime në aktivitete biznesore

Më pastaj, investimet në asetet e ujësjellësit dhe kanalizimit janë ndarë në: **asete të infrastrukturës dhe ato të jo-infrastrukturës**

Investimet kapitale në **Asetet Infrastrukturore** pastaj janë të ndara në investime: (i) të cilat bëhen për qëllime të përtëritjes infrastrukturës, (ii) dhe në investime të rritjes së infrastrukturës. Këto Investime karakterizohen si investime në asetet nëntokësore siç janë: gypat, pusetat, digat, rezervuarët nëntokësore, kanalet e ujit etj.

Investimet kapitale në **Asetet Jo-Infrastrukturore** bëjnë pjesë të gjitha investimet në asetet mbitokësore siç janë: (i) fabrikat për trajtimin e ujit, (ii) ndërtesat administrative, (iii) mjetet transportuese, (iv) pajisjet për zyrë etj. Ky grup i investimeve më pastaj kategorizohet në investime të mirëmbajtjes kapitale dhe rritjes së jo-infrastrukturës.

Për t'u njoftuar më në detaje për këto kategorizime mund të gjenden shpjegime në UKRR të cilat janë të publikuara në webfaqen zyrtare të ZRRUM.

Në tabelat e mëposhtme do të paraqiten investimet sipas kategorive të lartcekura për të gjitha KRU-të.

7.1. Shumat e Investimeve kapitale nga financimet vetanake

Në tabelën e më poshtme paraqiten shumat e investimeve kapitale me financim nga burimet vetanake të kompanive për kategorinë e shërbimeve të ujësjellësit. Më këtë bëhet krahasimi i shumave të investimeve kapitale të aprovuara nga ZRRUK me ato të realizuara nga KRU-të gjatë vitit 2012, % e realizimit të investimeve të planifikuara dhe vlerësimin tonë përfundimtarë.

Tabela Nr. 5. Shumat e investimeve kapitale për ujë të financiar nga burimet vetanake të kompanive sipas kategorive të theksuara ma lartë në €

Emri i kompanisë me kategori të Investimeve Kapitale	Aprovuara 2012	Realizuara 2012	% e real. të cakt 2012	Vlerësimi përfundimtar
1. PRISHTINA	5,791,048	1,624,579	28.05%	Jo e R
Resurse dhe trajtimi i ujit	1,560,722	43,517	2.79%	Jo e R
Distribui	3,274,913	681,584	20.81%	Jo e R
Aktivitetet biznesore	955,413	85,465	8.95%	Jo e R
Investimet në vijim	0	814,013	!	E pa K
2. HIDROREGJIONI-JUGOR	363,346	198,181	54.54%	Jo e R
Resurse dhe trajtimi i ujit	102,814	87,390	85.00%	Jo e R
Distribui	260,532	31,304	12.02%	Jo e R
Aktivitetet biznesore	0	79,487	!	E pa K
3. HIDRODRINI	377,958	28,496	7.54%	Jo e R
Resurse dhe trajtimi i ujit	0	9,700	!	E pa K
Distribui	375,028	18,796	5.01%	Jo e R
Aktivitetet biznesore	2,930	0	0.00%	Jo e R
4. MITROVICA	0	0	0	0
Resurse dhe trajtimi i ujit	0	0	0	0
Distribui	0	0	0	0
Aktivitetet biznesore	0	0	0	0
5. RADONIQI	409,646	108,243	26.42%	Jo e R
Resurse dhe trajtimi i ujit	10,281	2,155	20.96%	Jo e R
Distribui	379,829	21,030	5.54%	Jo e R
Aktivitetet biznesore	19,535	85,058	435.42%	T P
6. BIFURKACIONI	118,898	45,522	38.29%	Jo e R
Resurse dhe trajtimi i ujit	20,563	0	0.00%	Jo e R
Distribui	98,335	24,173	24.58%	Jo e R
Aktivitetet biznesore	0	21,349	!	E pa K
7. HIDROMORAVA	273,580	27,733	10.14%	Jo e R
Resurse dhe trajtimi i ujit	82,252	19,398	23.58%	Jo e R
Distribui	154,994	0	0.00%	Jo e R
Aktivitetet biznesore	36,335	8,335	22.94%	Jo e R
TOTALI	7,334,476	1,218,741	16.62%	Jo e R




Tabela Nr. 6. Shumat e investimeve kapitale për ujëra të zeza të financuar nga burimet vetanake të kompanive sipas kategorive të theksuara ma lartë në €

Emri i kompanisë me kategori të Investimeve Kapitale	Aprovuara 2012	Realizuara 2012	% e real. të cakt 2012	Vlerësimi përfundimtar
1. PRISHTINA	761,285	25,549	3.36%	Jo e R
Grumbullimi i u.z	731,736	12,456	1.70%	Jo e R
Trajtim i u.z	0	0	0	0
Trajtimi i llumit	0	0	0	0
Aktivitetet biznesore	29,549	2,643	8.95%	Jo e R
Investimet në vijim	0	10,450	!	E pa K
2. HIDROREGJIONI-JUGOR	157,227	10,839	6.89%	Jo e R
Grumbullimi i u.z	157,227	0	0.00%	Jo e R
Trajtim i u.z	0	0	0	0
Trajtimi i llumit	0	0	0	0
Aktivitetet biznesore	0	10,839	!	E pa K
3. HIDRODRINI	25,858	0	0.00%	Jo e R
Grumbullimi i u.z	25,704	0	0.00%	Jo e R
Trajtim i u.z	0	0	0	0
Trajtimi i llumit	0	0	0	0
Aktivitetet biznesore	154	0	0.00%	Jo e R
4. MITROVICA	139,931	0	0.00%	Jo e R
Grumbullimi i u.z	139,931	0	0.00%	Jo e R
Trajtim i u.z	0	0	0	0
Trajtimi i llumit	0	0	0	0
Aktivitetet biznesore	0	0	0	0
5. RADONIQI	139,931	4,477	3.20%	Jo e R
Grumbullimi i u.z	139,931	0	0.00%	Jo e R
Trajtim i u.z	0	0	0	0
Trajtimi i llumit	0	0	0	0
Aktivitetet biznesore	0	4,477	0	E pa K
6. BIFURKACIONI	203,967	7,421	3.64%	Jo e R
Grumbullimi i u.z	203,967	4,782	2.34%	Jo e R
Trajtim i u.z	0	0	0	0
Trajtimi i llumit	0	0	0	0
Aktivitetet biznesore	0	2,639	0	E pa K
7. HIDROMORAVA	119,042	627	0.53%	Jo e R
Grumbullimi i u.z	116,307	0	0.00%	Jo e R
Trajtim i u.z	0	0	0	0
Trajtimi i llumit	0	0	0	0
Aktivitetet biznesore	2,735	627	22.94%	Jo e R
TOTALI	1,547,241	38,463	2.49%	Jo e R

Tabela Nr. 7. Shumat e Investimeve kapitale të financuara nga burimet vetanke të kompanive për shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza në €

Emri i kompanisë	Investimet në shërbimet përkatëse	Njësia monetare	Historike 2011	Aprovuara nga ZRRUK 2012	Realizuar nga KRU 2012	% krahasuese 2012/2011	% e real. të cakt. 2012	Vlerësimi përfundimtar 2012
Prishtina	Ujë	€	1,021,79	5,791,048	810,566	79.33%	14.00%	Jo e R
	Ujë Inv. në vijim	€	!	!	814,013	!	!	E pa K
	Ujëra të zeza	€	7,064	761,285	15,099	213.74%	1.98%	Jo e R
	U.z Inv. në vijim	€	!	!	10,450	!	!	E pa K
	Totali	€	1,028,86	6,552,334	1,650,128	160.38%	25.18%	Jo e R
Hidroregjioni jugor (PZ)	Ujë	€	92,046	363,346	198,181	215.31%	54.54%	Jo e R
	Ujëra të zeza	€	5,309	157,227	10,839	204.16%	6.89%	Jo e R
	Totali	€	97,355	520,573	209,020	214.70%	40.15%	Jo e R
Hidrodrini (PE)	Ujë	€	83,199	377,958	28,496	34.25%	7.54%	Jo e R
	Ujëra të zeza	€	0	25,858	0	!	0.00%	Jo e R
	Totali	€	83,199	403,816	28,496	34.25%	7.06%	Jo e R
Mitrovica (MIT)	Ujë	€	0	0	0	0	0	0
	Ujëra të zeza	€	0	139,931	0	!	0.00%	Jo e R
	Totali	€	0	139,931	0	!	0.00%	Jo e R
Radoniqi (GJA)	Ujë	€	53,457	409,646	108,243	202.49%	26.42%	Jo e R
	Ujëra të zeza	€	1,849	139,931	4,477	242.13%	3.20%	Jo e R
	Totali	€	55,306	549,576	112,720	203.81%	20.51%	Jo e R
Bifurkacioni (FE)	Ujë	€	40,205	118,898	45,522	113.22%	38.29%	Jo e R
	Ujëra të zeza	€	4,802	203,967	7,421	154.54%	3.64%	Jo e R
	Totali	€	45,007	322,864	52,943	117.63%	16.40%	Jo e R
Hidromorava (GJI)	Ujë	€	11,724	273,580	27,733	236.55%	10.14%	Jo e R
	Ujëra të zeza	€	650	119,042	627	96.52%	0.53%	Jo e R
	Totali	€	12,374	392,622	28,360	229.19%	7.22%	Jo e R
Të dhënat sektoriale	Ujë	€	1,302,42	7,334,476	2,032,754	156.07%	27.72%	Jo e R
	Ujëra të zeza	€	19,674	1,547,241	48,913	248.62%	3.16%	Jo e R
Totali i përgjithshëm sektorial		€	1,322,10	8,881,716	2,081,66	157.45%	23.44%	Jo e R

7.2. Paraqitja grafike e të dhënave për investime kapitale vetanake të kompanive



7.3. Shumat e investimeve kapitale të financuara nga donatorët

Në këtë tabelë paraqiten të dhënat e shumave të aprovuara dhe realizuara nga financimet e donatorëve të cilët kanë qenë pjesë të planifikimit të projekteve për realizim të investimeve kapitale për shërbimet e ujit gjatë vitit 2012. Krahasimi i këtyre të dhënave pasqyron shkallën e përmbushjes së objektivave të përcaktuara për këtë periudhë kohore, të cilat epen në % me vlerësimin përfundimtarë.

Tabela Nr. 8. Shumat e investimeve kapitale për ujë të financuar nga donatorët sipas kategorive të theksuara më lartë në €

Emri i kompanisë me kategori të Investimeve Kapitale	Aprovuara 2012	Realizuara 2012	% e real. të caktut 2012	Vlerësimi përfundimtar
1. PRISHTINA	5,811,986	4,166,044	71.68%	Jo e R
Resurse dhe trajtimi i ujit	1,878,575	0	0.00%	Jo e R
Distribuim	3,933,411	4,166,044	105.91%	T P
Aktivitetet biznesore	0	0	0	0
2. HIDROREGJIONI-JUGOR	4,173,138	3,074,311	73.67%	Jo e R
Resurse dhe trajtimi i ujit	296,889	861,546	290.19%	T P
Distribuim	3,456,890	1,871,980	54.15%	Jo e R
Aktivitetet biznesore	419,359	340,784	81.26%	Jo e R
3. HIDRODRINI	2,097,414	3,244,595	154.70%	T P
Resurse dhe trajtimi i ujit	1,028,144	0	0.00%	Jo e R
Distribuim	1,069,270	3,057,529	285.95%	T P
Aktivitetet biznesore	0	187,066	!	E pa K
4. MITROVICA	11,201,628	20,184	0.18%	Jo e R
Resurse dhe trajtimi i ujit	9,253,295	0	0.00%	Jo e R
Distribuim	1,948,333	0	0.00%	Jo e R
Aktivitetet biznesore	0	20,184	!	E pa K
5. RADONIQI	154,222	275,412	178.58%	T P
Resurse dhe trajtimi i ujit	154,222	70,098	45.45%	Jo e R
Distribuim	0	160,762	!	E pa K
Aktivitetet biznesore	0	44,552	!	E pa K
6. BIFURKACIONI	750,545	637,283	84.91%	Jo e R
Resurse dhe trajtimi i ujit	30,844	0	0.00%	Jo e R
Distribuim	719,701	637,283	88.55%	Jo e R
Aktivitetet biznesore	0	0	0	0
7. HIDROMORAVA	859,528	1,288,765	149.94%	T P
Resurse dhe trajtimi i ujit	822,515		95.45%	Jo e R
Distribuim	37,013	154,607	417.71%	T P
Aktivitetet biznesore	0	349,080	!	E pa K
TOTALI	25,048,460	12,706,595	50.73%	Jo e R




Tabela Nr. 9. Shumat e investimeve kapitale për ujëra të zeza të financuara nga donatorët sipas kategorive të theksuara më lartë në €

Emri i kompanisë me kategori të Investimeve Kapitale	Aprovuara 2012	Realizuara 2012	% e real. të cakt. 2012	Vlerësimi përfundimtar
1. PRISHTINA	1,853,743	0	0.00%	Jo e R
Grumbullimi i u.z	1,442,486	0	0.00%	Jo e R
Trajtim i u.z	411,258	0	0.00%	Jo e R
Trajtimi i llumit	0	0	0	0
Aktivitetet biznesore	0	0	0	0
2. HIDROREGJIONI-JUGOR	853,483	46,471	5.44%	Jo e R
Grumbullimi i u.z	849,247	0	0.00%	Jo e R
Trajtim i u.z	0	0	0	0
Trajtimi i llumit	0	0	0	0
Aktivitetet biznesore	4,236	46,471	1097.05%	T P
3. HIDRODRINI	2,261,917	1,387,652	61.35%	Jo e R
Grumbullimi i u.z	205,629	1,377,806	670.05%	T P
Trajtim i u.z	1,814,674	0	0.00%	Jo e R
Trajtimi i llumit	241,614	0	0.00%	Jo e R
Aktivitetet biznesore	0	9,846	0	E pa K
4. MITROVICA	3,598,504	1,288	0.04%	Jo e R
Grumbullimi i u.z	0	0	0	0
Trajtim i u.z	3,598,504	0	0.00%	Jo e R
Trajtimi i llumit	0	0	0	0
Aktivitetet biznesore	0	1,288	0	E pa K
5. RADONIQI	10,281	2,345	22.81%	Jo e R
Grumbullimi i u.z	10,281	0	0.00%	Jo e R
Trajtim i u.z	0	0	0	0
Trajtimi i llumit	0	0	0	0
Aktivitetet biznesore	0	2,345	0	E pa K
6. BIFURKACIONI	821,682	0	0.00%	Jo e R
Grumbullimi i u.z	821,682	0	0.00%	Jo e R
Trajtim i u.z	0	0	0	0
Trajtimi i llumit	0	0	0	0
Aktivitetet biznesore	0	0	0	0
7. HIDROMORAVA	0	26,275	0	E pa K
Grumbullimi i u.z	0	0	0	0
Trajtim i u.z	0	0	0	0
Trajtimi i llumit	0	0	0	0
Aktivitetet biznesore	0	26,275	0	E pa K
TOTALI	9,399,610	1,464,030	15.58%	Jo e R

Tabela Nr. 10. Shumat e investimeve kapitale të aprovuar dhe realizuar nga donatorët për shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza gjatë vitit 2012

Emri i kompanisë	Investimet në shërbimet përkatëse	Njësia monetare	Historike 2011	Aprovuar nga ZRRUK 2012	Realizuar nga KRU 2012	% krahasues e 2012/2011	% e real. të caktut 2012	Vlerësimi përfundimtar 2012
Prishtina (PR)		€	301	5,811,986	4,166,04	1384067%	71.68%	Jo e R
	Ujëra të zeza	€	9	1,853,743	0	0.00%	0.00%	Jo e R
	Totali	€	310	7,665,730	4,166,04	1343885.	54.35%	Jo e R
Hidroregjioni jugor (PZ)	Ujë	€	1,755,47	4,173,138	3,074,31	175.13%	73.67%	Jo e R
	Ujëra të zeza	€	1,897	853,483	46,471	2449.69%	5.44%	Jo e R
	Totali	€	1,757,37	5,026,621	3,120,78	177.58%	62.09%	Jo e R
Hidrodrini (PE)	Ujë	€	751,739	2,097,414	3,244,59	431.61%	154.70	T P
	Ujëra të zeza	€	710	2,261,917	1,387,65	195443.8	61.35%	Jo e R
	Totali	€	752,449	4,359,330	4,632,24	615.62%	106.26	T P
Mitrovica (MIT)	Ujë	€	759,502	11,201,628	20,184	2.66%	0.18%	Jo e R
	Ujëra të zeza	€	2,176	3,598,504	1,288	59.21%	0.04%	Jo e R
	Totali	€	761,678	14,800,131	21,473	2.82%	0.15%	Jo e R
Radoniqi (GJA)	Ujë	€	109,295	154,222	275,412	251.99%	178.58	T P
	Ujëra të zeza	€	4,679	10,281	2,345	50.11%	22.81%	Jo e R
	Totali	€	113,974	164,503	277,757	243.70%	168.85	T P
Bifurkacioni (FE)	Ujë	€	192,232	750,545	637,283	331.52%	84.91%	Jo e R
	Ujëra të zeza	€	28,296	821,682	0	0.00%	0.00%	Jo e R
	Totali	€	220,528	1,572,227	637,283	288.98%	40.53%	Jo e R
Hidromorava (GJI)	Ujë	€	126,672	859,528	1,288,76	1017.40%	149.94	T P
	Ujëra të zeza	€	9,634	0	26,275	272.73%	0	E pa K
	Totali	€	136,306	859,528	1,315,04	964.77%	153.00	T P
Të dhënat sektoriale	Ujë	€	3,695,21	25,048,460	12,706,5	343.87%	50.73%	Jo e R
	Ujëra të zeza	€	47,401	9,399,610	1,464,03	3088.61%	15.58%	Jo e R
Totali i përgjithshëm sektorial		€	3,742,61	34,448,070	14,170,6	378.63%	41.14%	Jo e R

7.4. Paraqitja grafike e të dhënave për investimet kapitale nga donatorët




7.5. Investimet në përtëritjen e infrastrukturës

Është e njohur nga praktika e gjertanishme se të gjitha asetet kanë një jetëgjatësi të caktuar, prandaj për ato alokohet pjesa përkatëse e mjeteve financiare (në rastin tonë asetet jo-infrastrukturore) në mënyrë që në fund të jetëgjatësisë së tyre tu zgajtet vlera e përdorimit të tyre ose të blihen asete të reja dhe të zëvendësohen me ato të vjetrat. Karakteristikë e kontabilitetit rregullator është se asetet të cilat gjenden nën nivelin e tokës (asetet infrastrukturore) nuk amortizohen, por atyre u njihet shpenzimi për përtëritjen e infrastrukturës në shumën e aprovuar me procesin rregullator. ZRRUK ka konstatuar se kjo kategori e investime ka ndikim direkt në nivelin e shërbimeve.

Shuma e duhur e mjeteve financiare të nevojshme për përtëritje efektive infrastrukturore është vështirë të përcaktohet, por pas një periudhe të arsyeshme kohore dhe me të dhëna të mjaftueshme për shpenzime dhe për performancë është e mundur që të ndërlidhet shkalla e shpenzimeve me përmirësimin apo përkeqësimin e shërbyeshmërisë së infrastrukturës.

Në mungesë të të dhënave të besueshme për performancën e menaxhimit të aseteve në shqyrtimin tarifar 2012-2014, shumën e mjeteve fillestare të planifikuara për investime në përtëritjen e infrastrukturës është përcaktuar si një shpenzim vjetor prej të paktën 10% të vlerës së BRA për shërbimet e furnizimit me ujë dhe 10% të vlerës së BRA të sistemit për shërbimet e ujërave të zeza. Për procesin rregullator të tarifave 2012-2014 pas akordimit të arritur për të siguruar një nivel më të mirë të shërbimeve dhe ngritje minimale të tarifave reale është vendosë që tarifatat e shërbimeve të ujit të ngriten për BRRA të ujit me 4% viti pas viti dhe ato të shërbimeve të ujit me 10% . Ky proces është i ilustruar në figurën mëposhtme.



Konform këtij procesi, për të gjitha KRU-të janë bërë rregullimet e nevojshme për të pasqyruar shumën e përtëritjes së infrastrukturës, siç edhe do të paraqiten në tabelat në vijim për vitin 2012.

Tabela Nr.11. Investimet në përtëritjen e infrastrukturës për ujë

Emri i Kompanisë	Planifikuara nga KRU 2012		Aprovuara nga ZRRUK 2012		Realizuara nga KRU 2012		Vlerësimi përfundimtar	
	Vetanake	Donacion	Vetanake	Donacion	Vetanake	Donacion	Vetanake	Donacion
PRISHTINA	1,766,351	2,853,860	2,817,389	2,853,860	227,364	2,519,173	Jo e R	Jo e R
HIDROREGJIONI JUGOR	176,738	1,513,428	176,738	1,513,428	0	684,471	Jo e R	Jo e R
HIDRODRINI	51,407	601,464	270,158	601,464	9,700	379,775	Jo e R	Jo e R
MITROVICA	0	1,850,659	0	1,850,659	0	0	E pa K	Jo e R
RADONIQI	10,281	154,222	390,111	154,222	0	0	Jo e R	Jo e R
BIFURKACIONI	0	442,102	74,687	442,102	12,368	0	Jo e R	Jo e R
HIDROMORAVA	0	37,013	154,994	37,013	0	154,607	Jo e R	T P
TOTALI	2,004,778	7,452,748	3,884,076	7,452,748	249,432	3,738,025	Jo e R	Jo e R

Tabela Nr.12. Investimet në përtëritjen e infrastrukturës për ujëra të zeza

Emri i Kompanisë	Planifikuara nga KRU 2012		Aprovuara nga ZRRUK 2012		Realizuara nga KRU 2012		Vlerësimi përfundimtar	
	Vetanake	Donacion	Vetanake	Donacion	Vetanake	Donacion	Vetanake	Donacion
PRISHTINA	388,638	1,442,486	731,736	1,442,486	6,990	0	Jo e R	Jo e R
HIDROREGJIONI JUGOR	102,814	822,515	121,242	822,515	0	0	Jo e R	Jo e R
HIDRODRINI	25,704	807,093	25,704	807,093	0	0	Jo e R	Jo e R
MITROVICA	0	0	139,930	0	0	0	Jo e R	Jo e R
RADONIQI	0	10,281	139,930	10,281	0	0	Jo e R	Jo e R
BIFURKACIONI	1,542	461,832	201,910	461,832	4,782	0	Jo e R	Jo e R
HIDROMORAVA	0	0	116,307	0	0	37,106	Jo e R	E pa K
TOTALI	518,699	3,544,207	1,476,760	3,544,207	11,772	37,106	Jo e R	Jo e R

Tabela Nr.13. Investimet në përtëritjen e infrastrukturës për shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza

Emri i Kompanisë	Planifikuara nga KRU 2012		Aprovuara nga ZRRUK 2012		Realizuara nga KRU 2012		Vlerësimi përfundimtar	
	Vetanake	Donacion	Vetanake	Donacion	Vetanake	Donacion	Vetanake	Donacion
PRISHTINA	2,154,990	4,296,346	3,549,126	4,296,346	234,354	2,519,173	Jo e R	Jo e R
HIDROREGJIONI JUGOR	279,552	2,335,943	297,980	2,335,943	0	684,471	Jo e R	Jo e R
HIDRODRINI	77,111	1,408,557	295,861	1,408,557	9,700	379,775	Jo e R	Jo e R
MITROVICA	0	1,850,659	139,930	1,850,659	0	0	Jo e R	Jo e R
RADONIQI	10,281	164,503	530,041	164,503	0	0	Jo e R	Jo e R
BIFURKACIONI	1,542	903,934	276,597	903,934	17,150	0	Jo e R	Jo e R
HIDROMORAVA	0	37,013	271,301	37,013	0	154,607	Jo e R	T P
TOTALI	2,523,476	10,996,955	5,360,837	10,996,955	261,204	3,738,025	Jo e R	Jo e R

8. PËRSHTATJA E TARIFAVE PËR VITIN 2013

Siç edhe është potencuar gjatë këtij raporti, ZRRUK ka përcaktuar tarifat trevjeçare për vitet 2012-2014. Gjatë këtij procesi është dakorduar në mes të ZRRUK dhe KRU-ve se aprovimi i këtyre tarifave në vete ndërthur edhe përmbushjen e një mori caqesh, përmes të cilave kërkohet nga KRU-të që të jenë më efektive. Ndër caqet më me ndikim, për të cilën ZRRUK i kushton shumë vëmendje, janë Investimet Kapitale, e sidomos ato prej burimeve vetanake të KRU-ve.

Nga ky raport është konstatuar se KRU-të janë larg përmbushjes së caktuar për t'i realizuar investimet kapitale prej burimeve vetanake, e të cilat kanë ndikim direkt në lartësinë e tarifave. Kështu që, për të mos tingëlluar se ZRRUK bën vetëm ngritjen e tarifave, pa shikuar edhe përmbushjen e caqeve, ne kemi bërë përshtatje të tarifës për vitin 2013, e cila mund të konsiderohet si një lloj ndëshkimi për KRU-të për mos realizimin e investimeve kapitale të cilin e kemi aplikuar edhe gjatë procesit të mëparshëm rregullator 2009-2011.

Sipas politikave tarifore, si dhe akteve tjera rregullative, tarifat e vitit 2013 do duhej të përshtateshin me normën e inflacionit të ndodhur gjatë periudhës së shikuar kohore; e tetor/2010 – dhjetor/2012 e cila ka qenë 8.919% e të cilat nuk janë përshtat, d.mth. nuk janë ngrit sipas procedurave dhe politikave të përcaktuara, pasi që kompanitë në përgjithësi kanë dështuar me i realizua investimet e veta kapitale të financuara nga burimet vetanake. Duke marr parasysh faktin se kompanitë në shumicën e rasteve nuk i kanë përmbush caqet përcaktuara me procesin rregullator të tarifave për vitin 2012 dhe sidomos ato të investimeve kapitale, tarifat e vitit 2013 janë ngrit vetëm pjesërisht.

Metodologjia e rishikimit të tarifave të shërbimit të ujit për vitin 2013 është bazuar në shkallen e realizimit të investimeve kapitale të financuar nga çdo kompani veç e veç, të cilat i kemi fut në raport me lëvizjet inflatore sipas IÇKK të ASK të periudhës së shikuar kohore.

Për t'u kuptuar më lehtë ajo që u theksua ma lartë në tabelën e më poshtëm po paraqesim një pasqyrë të tarifave e cila ka për bazë tarifën e vitit 2012, tarifat e përcaktuar pa inflacion nga rregullatori për vitin 2013 nga procesi rregullator i tarifave 2012-2013 dhe tarifat me inflacion të ndodhur për periudhën tetor/2010 – dhjetor/2012 vitin për vitin 2013 si tarifa oblikative për faturim të cilat në vete nuk përmbajnë tarifat fikse dhe TVSH-ën e aplikueshme. Kjo pasqyrë e tarifave mund të pësoj ndryshime në versionin e fundit.

Tabela Nr. 13 Pasqyra e përshtatjes së tarifave të vitit 2013 për çdo kompani

KRU	Kosto qendra	Kategoria e konsumat.	Njësia	Tarifat finale 2012	Tarifat 2013 pa inflacion	Tarifat 2013 me inflacion pa përshtatje	Tarifat finale 2013 me % e realiz. të projekteve
PR	Ujë	Shtëpiak	€/m ³	0.37	0.371	0.404	0.38
		Jo-shtëpiak	€/m ³	0.87	0.853	0.929	0.87
	Kanalizim	Shtëpiak	€/m ³	0.05	0.050	0.054	0.05
		Jo-shtëpiak	€/m ³	0.11	0.114	0.124	0.11
PZ	Ujë	Shtëpiak	€/m ³	0.31	0.335	0.365	0.35
		Jo-shtëpiak	€/m ³	0.61	0.654	0.712	0.69
	Kanalizim	Shtëpiak	€/m ³	0.05	0.049	0.054	0.05
		Jo-shtëpiak	€/m ³	0.09	0.088	0.096	0.09
PE	Ujë	Shtëpiak	€/m ³	0.22	0.228	0.248	0.23
		Jo-shtëpiak	€/m ³	0.43	0.455	0.496	0.47
	Kanalizim	Shtëpiak	€/m ³	0.06	0.064	0.069	0.06
		Jo-shtëpiak	€/m ³	0.12	0.128	0.139	0.13
MIT	Ujë	Shtëpiak	€/m ³	0.33	0.350	0.381	0.35
		Jo-shtëpiak	€/m ³	0.73	0.700	0.762	0.70
	Kanalizim	Shtëpiak	€/m ³	0.08	0.102	0.111	0.10
		Jo-shtëpiak	€/m ³	0.20	0.255	0.278	0.26
GJA	Ujë	Shtëpiak	€/m ³	0.33	0.341	0.371	0.35
		Jo-shtëpiak	€/m ³	0.72	0.681	0.742	0.70
	Kanalizim	Shtëpiak	€/m ³	0.07	0.084	0.091	0.08
		Jo-shtëpiak	€/m ³	0.16	0.210	0.229	0.21
FE	Ujë	Shtëpiak	€/m ³	0.31	0.311	0.339	0.32
		Jo-shtëpiak	€/m ³	0.68	0.623	0.679	0.64
	Kanalizim	Shtëpiak	€/m ³	0.13	0.130	0.142	0.13
		Jo-shtëpiak	€/m ³	0.30	0.325	0.354	0.33
GJI	Ujë	Shtëpiak	€/m ³	0.32	0.317	0.346	0.33
		Jo-shtëpiak	€/m ³	0.71	0.634	0.691	0.65
	Kanalizim	Shtëpiak	€/m ³	0.08	0.080	0.087	0.08
		Jo-shtëpiak	€/m ³	0.19	0.200	0.218	0.20
SEKTORI	Ujë	Shtëpiak	€/m ³	0.313	0.322	0.351	0.330
		Jo-shtëpiak	€/m ³	0.679	0.657	0.716	0.674
	Kanalizim	Shtëpiak	€/m ³	0.074	0.080	0.087	0.079
		Jo-shtëpiak	€/m ³	0.167	0.189	0.205	0.190